

**LIGJ**  
**Nr. 165/2020**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9179, DATË 29.1.2004,  
“PËR NJË TRAJTIM TË VEÇANTË TË PUNONJËSVE QË KANË PUNUAR NË  
DISA NDËRMARRJE TË INDUSTRIISË USHTARAKE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 4

Përfitojnë trajtim të veçantë punonjësit e ndërmarrjeve të sistemit të industrisë ushtarake, të cilët:

- në datën 31.12.2002 kanë qenë në marrëdhënie pune ose janë trajtuar në bazë të vendimeve të Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 8.8.2002, dhe nr. 695, datë 27.12.2002, në Kombinatin Mekanik në Poliçan, në Uzinën e Lëndëve Plasëse në Mjekës, në Uzinën Mekanike dhe Uzinën e Pilave në Gramsh dhe në Uzinën e Riparimit të Avionëve në Kuçovë;
- kanë vazhduar të punojnë pas datës 30.9.2004 dhe ndërpresin marrëdhëniet e punës me ndërmarrjet e sistemit të industrisë ushtarake deri në datën 31.12.2020;
- kanë një periudhë pune ose gatishmërie jo më pak se 17 vjet dhe periudhë sigurimi jo më pak se 20 vjet për gratë, dhe periudhë pune ose gatishmërie jo më pak se 20 vjet dhe periudhë sigurimi jo më pak se 25 vjet për burrat;
- nuk ushtrojnë veprimtari ekonomike.”.

Neni 2

Në nenin 6 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“E drejta e kërkesës për përfitime për personat që përfitojnë sipas paragrafit të dytë të nenit 4 të ligjit, ushtrohet brenda datës 1.4.2021. E drejta për përfitime lind nga data e paraqitjes së kërkesës pranë drejtorive rajonale të sigurimeve shoqërore.”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 23.12.2020

**Shpallur me dekretin nr. 11901 , datë 5.1.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Ilir Meta.**